



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:281129
Datë: 24.11.2020
Numri i dokumentit: 01294336

III.EK.nr.725/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti Për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit [“F...”] sh.p.k”, me NRB , me seli në Velekincë Komuna e Gjilanit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e avokatëve [“S&Q”] sh.p.k respektivisht avokati [“T.H”] nga Prishtina, kundër të paditurës [“Y...”] sh.p.k”, me NRB , me seli në Gjakovë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Bajram Morina avokat nga Gjakova, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, pas përfundimit të seancës kryesore publike të datës 27.10.2020, në prani të autorizuarit të paditëses dhe të autorizuarit të paditurës, dhe pas marrjes së fjalëve përfundimtare me shkrim nga palët në procedurë, me datë 09.11.2020 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit [“F...”] sh.p.k”, me NRB , me seli në Velekincë Komuna e Gjilanit, me të cilën ka kërkuar si në vijim;

- Të vërtetohet se e paditura [“Y...”] sh.p.k”, me NRB , me seli në Gjakovë, ka shkelur markën tregtare të paditësit.

-Të vërtetohet se e paditura [“Y...”] sh.p.k” ka kryer veprimin e konkurrencës jolojale në raport me paditësin, të vërtetohet se e paditura ka kryer veprim jo të drejtë të praktikës afariste.

-Të urdhërohet e paditura që me shpenzimet e veta të tërheqë në tërësi produktin i cili shkelë të drejtat e markës tregtare të paditësit.

-Të urdhërohet e paditura që me shpenzimet e veta të tërheqë në tërësi produktin i cili shkelë të drejtat e markës tregtare të paditësit.

-Të detyrohet e paditura që të ndalojë prodhimin e mëtutjeshëm të produkteve të cilat kopjojnë produktet e paditësit.

-Të detyrohet e paditura që t’i kompensojë paditësit dëmin material, dëm ky që do të precizohet pas nxjerrjes së ekspertizës përkatëse, si dhe ti paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. DETYROHET paditësi që palës së paditur t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 748.80 euro, në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve pas pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi ["F..."] sh.p.k", me NRB , me seli në Velekincë Komuna e Gjilanit, ka parashtuar pranë kësaj gjykate padi me datë 02.12.2019, kundër të paditurës ["Y..."] sh.p.k", me NRB , me seli në Gjakovë, duke i propozuar kësaj gjykate që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit me të cilën do të vërtetohet se e paditura ["Y..."] sh.p.k", me NRB , me seli në Gjakovë ka shkelur markën tregtare të paditësit, të vërtetohet se e paditura ["Y..."] sh.p.k" ka kryer veprimin e konkurrencës jolojale në raport me paditësin, të vërtetohet se e paditura ka kryer veprim jo të drejtë të praktikës afariste, të urdhërohet e paditura që me shpenzimet e veta të tërheqë në tërësi produktin i cili shkelë të drejtat e markës tregtare të paditësit, të urdhërohet e paditura që me shpenzimet e veta të tërheqë në tërësi produktin i cili shkelë të drejtat e markës tregtare të paditësit, të detyrohet e paditura që të ndalojë prodhimin e mëtutjeshëm të produkteve të cilat kopjojnë produktet e paditësit, të detyrohet e paditura që t'i kompensojë paditësit dëmin material, dëm ky që do të precizohet pas nxjerrjes së ekspertizës përkatëse, si dhe ti paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore .

I autorizuari i paditësit gjatë gjithë shqyrtimit të çështjes gjyqësore ka mbetur pranë padisë dhe kërkesës së tij, duke shtuar se paditësi është pronar i markës tregtare të regjistruar pranë zyrës për pronësi industriale në Kosovë dhe fillimisht me vendimin me numër të regjistrimit 8315 të datës 25.07.2012, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë -Zyra e Pronësisë Industriale, paditësi ka fituar të drejtën në markë tregtare me të drejtë të përparësisë. Po ashtu me vendimin me numër të regjistrimit 1276 të datës 10.11.2016, paditësi ka bërë vazhdimin e regjistrimit edhe të një marke tregtare të tij, përkatësisht vazhdimi i mbrojtjes së markës tregtare është bërë deri me datën 08.06.2026, për më tepër me vendimet me numër të regjistrimit 25222 të datës 09.07.2019, nr.25206 të dt.09.07.2019, nr.25205 të dt.09.07.2019, nr.25203 të dt.09.07.2019, nr.25201 të dt.09.07.2019, nr.25200 të dt.09.07.2019, nr.25043 të dt.14.06.2019, nr.25035 të dt.14.06.2019, nr.25036 të dt.14.06.2019, nr.25037 të dt.14.06.2019, nr.25038 të dt.14.06.2019, nr.25039 të dt.14.06.2019, nr.25040 të dt.14.06.2019, nr.25041 të dt.14.06.2019 si dhe vendimi nr.25042 të dt.14.06.2019, kështu paditësi ka të fituar të drejtën e këtyre markave për një periudhë 10 vjeçare, përkatësisht nga viti 2018 e deri në vitin 2028. Ka theksuar se janë këto marka tregtare të cilat kanë të bëjnë me produktet 2 litërshe të paditësit dhe të cilat e paditura i ka vënë në treg me dukje tërësisht të njëjtë, dhe se këto lloje të produktev ishin vënë në qarkullim në tregun e Kosovës me emërtimin "Sende" dhe janë në pronësi të paditurit, pra është e paditura ajo e cila i ka lëshuar në tregun e Kosovës produktet në fjalë, po ashtu ka theksuar se produktet e emërtimit "Sende" janë tërësisht të kopjuara me produktet përkatësisht me lëngjet dy litërshe që i prodhon paditësi, andaj edhe i ka kërkuar gjykatës që kërkesëpadija e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

I autorizuari i të paditurës përmes përgjigjes në padi dhe gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se e paditura nuk ka bërë kopjimin apo shkeljen e markës tregtare të paditësit, pasi që ambalazhet e lëngjeve i dizajnuar nga paditësi nuk ka ngjashmëri me dizajnin e ambalazhit të paditurës emri i markës tregtare të paditësit është ["J..."] kurse emri i markës tregtare të paditurës është "Sende -Fruite Juice" rrethanë kjo që

vërteton faktin se në mes markës tregtare të paditësit dhe asaj të paditurës nuk ka asnjë ngjashmëri, ka shtuar se me vendimin për vazhdimin e markës tregtare [“J...”] me nr.1276 dt.10.11.2016 klasa 32 i vlefshëm gjerë me datën 08.06.2020, vërtetohet se objekt i regjistrimit është marka tregtare [“J...”] dhe se bartësi i së drejtës nuk është paditësi por një subjekt tjetër ekonomik -Pup [“F...”] D.o.o Preshevë -Serbi, ndërsa vendimet tjera bartës i të drejtës është paditësi. Ndër të tjerash ka theksuar se e paditura nuk ka kryer veprime të konkurrencës jolojale e as veprime jo të drejta të praktikës afariste, pasi kësi lloj të veprimeve konsiderohet se ka kryer paditësi bazuar në faktin se me padinë-kërkesëpadinë e tij ka kërkuar nga gjykata që ti ndalohet të paditurës prodhimi i mëtutjeshëm i produkteve të saja pa dhënë asnjë bazë ligjore për këtë kërkesë , andaj dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata ka administruar këto prova duke lexuar: vendimi i dt.10.11.2016, aplikacioni për vazhdimin e markës së paditësit vendimi i dt.10.11.2016 nr.1276, së bashku me aplikacionin, vendimi me nr.25222 i dt.09.07.2019, 09.07.2019, përgjigje e ftesës për regjistrim e dt.05.07.2019, faturë me nr. e dt.09.07.2019, vendim nr.25206 dt. 09.07.2019, përgjigje e ftesës për regjistrim e dt.05.07.2019, ftesës për pagesë të regjistrimit 12.06.2019, vendimi nr.25222, 09.07.2019, së bashku 09.07.2019, faturë e , vendim me nr. 25205, i dt.09.07.2019, së bashku me ftesën për pagesë 12.06.2019, përgjigje e ftesës e dt.09.07.2019, vendim me nr. 25205, i dt.09.07.2019, vendim nr. 25207 i dt.09.07.2019, vendim 25200 e dt.09.07.2019, vendim 25403 e dt.14.06.2019, vendim 25035 dt.14.06.2019, vendim nr.25036 e dt.14.06.2019 vendim 25037, datë.14.06.2019, vendim me nr.25038 dt.14.06.2019, vendim me nr.25039 i dt.14.06.2019, vendim me nr.25040 i dt.14.06.2019, vendim me nr.25041 i dt.14.06.2019, vendim me nr.25042 i dt.14.06.2019, Vendim me nr.8315 i dt.25.07.2012, (të gjitha vendimet janë të përcjellura me ftesë regjistrimi) regjistrimi i markës [“J...”] e dt.10.01.2013, mostrat e produkteve të paditurit dhe mostrat e produkteve të paditësit, kërkesë për ndalimin e shitjes muaji tetor 2019. Si dhe përgjigja ndaj kërkesës e dt.22.10.2019.

Provat e propozuara dhe të administruara, deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, gjykata i vlerësoi, të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të LPK-së, dhe gjeti se:

Nga vendimet me nr.1276 dt.10.11.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka të mbrojtur markën tregtare me emrin [“J...”] deri me datën 08.06.2026.

Nga vendimi me nr.25222 dt.09.07.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka të mbrojtur markën tregtare me emrim [“J...”] [“A...”]. Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e regjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25206 dt.09.07.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emrim [“J...”] A+C+E;Plus;Multifrutti” Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25205 dt.09.07.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emrim [“J...”] [“B...”] të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për

pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25203 dt.09.07.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] [“G...”][“A...”]” Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25201 dt.09.07.2019 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] [“A...”]” të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25200 dt.09.07.2019 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] 100% Orange ;No Suger Added Plus”. Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25043 dt.14.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] Orange Nectarina;Plus”. Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25035 dt.14.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] Orange Plus” Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencioni i Pronësisë Industriale.

Nga vendimi me nr.25036 dt.14.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] Sour Cherry;Plus”. Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencioni i Pronësisë Industriale.

Nga vendimi me nr.25037 dt.14.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] Strëberry;Plus”. Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencioni i Pronësisë Industriale.

Nga vendimi me nr.25038 dt.14.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] Straëberry&Banana;Plus” Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25039 dt.14.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] Nectarina Orange:Plus”. Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe

Industrië-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25040 dt.14.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] Peach;Plus”, Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrië-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25041 dt.14.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] Ice Tea;Forest Berries” Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrië-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.25042 dt.14.06.2019 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] Ice Tea;Peach” Të njëjtin vendim e mbështet edhe Ftesën për pagesën e rregjistrimit për markë tregtare e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrië-Agjencioni i Pronësisë Industriale. Kjo markë tregtare është e mbrojtur deri me datën 10.05.2028.

Nga vendimi me nr.8315 dt.25.07.2012 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi e ka mbrojtur markën tregtare me emërim “[“J...”] ” me ngjyrë të bardhë, të kuqe, e gjelbër, deri me datën 25.01.2028.

Nga shkresa e muajit Tetor 2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka njoftuar të paditurën lidhur me kërkesën për ndërprerjen e shkeljes së markës tregtare, nuk ka qenë kontestuese në mes palëve në procedurë.

Nga përgjigjja e datës 22.10.2019, e të paditurës e bërë në shkresën e paditësit të muajit Tetor 2019, gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura e ka kundërshtuar pretendimet e paditësit.

Kështu gjykata pas administrimit të provave të cekura pas vlerësimit dhe analizimit të gjitha pretendimeve të palëve në procedurë të cekura në procesverbal edhe parashtresa gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar për këto arsye:

Nga vështrimi me kujdes i paketimeve të kontestuara gjykata ka gjetur se këto paketime janë të dallueshme dhe nuk përngjajnë njëra me tjetrën edhe pse kanë përafërsisht ngjyrë të njëjtë. Janë shenja të tjera që dallohen esencialisht siç janë: emri personal i markës, skicimi i markës, shkronjat e paketimit si dhe figurat tjera e që në mënyrë të qartë e bëjnë dallimin mes tyre.

Paketimet e paditësit të mbrojtur me vendimet e lartë cekura kanë shkronja të tjera identifikuese siç janë: “[“J...”]”, e që këtë emërtim nuk e ka paketimi i të paditurit “Sende”. Pastaj emërtimi nën emrin “[“J...”]” është fjala “Plus” e përcjellur me fjalën (për secilën paketim është emri frutave) p.sh “[“A...”]” në gjuhën angleze, e që fjala e parë është me shkronja të bardha kurse në brendi të këtyre fjalëve njëra ka ngjyrë të kuqe tjera ngjyrë të gjelbër, me shkronja të shtypura të një stili tjetër të vendosura në pjesën mbështjellëse të paketimit me ngjyrë të verdhë, veçori këto të cilat nuk i ka produkti i të paditurës pasi që e njëjta ka emërtim “Sende” me ngjyrë të kaltër e rrethuar me vija të bardha, më poshtë ka mbishkrimin “Fruite Juice” dhe nën këtë fjalë është (për secilën paketim emri i frutave) p.sh. “[“A...”]” dhe “Molle” në gjuhën shqipe dhe angleze, që dallon nga produktet e paditësit. Pastaj në paketimet e paditësit fotot e frutave dallojnë nga foto

e paketimeve të të paditurit, veçori këto të cilat e bëjnë të dallueshme dhe që nuk kanë ngjashmëri produkti i të paditurës me produktin e paditësit.

Sipas nenit 5 të Ligjit për markat Tregtare, kusht për regjistrimin e markës tregtare është mundësia e paraqitjes grafike të markës, ndërsa me vendimin e MTI-së, marka tregtare e paditësit “[“J...”]” është regjistruar si kombinim i ngjyrave të mbrojtura e bardhë, e kuqe dhe e gjelbër në dizajnin e caktuar dhe se kjo markë tregtare gëzon mbrojtje vetëm me këtë dizajn të dhënë në vendim, sepse do të ishte jashtë çdo logjike që paditësi me vetë faktin e regjistrimit dhe mbrojtjes së ngjyrave të caktuara t’ia mohojë çdo prodhuesi përdorimin e këtyre ngjyrave në çfarëdo forme dhe në çfarëdo kombinimi. Prandaj gjykata ka vlerësuar se përdorimi i ngjyrave përafërsisht të njëjta me nuanca dalluese në produktin e të paditurës, në dizajn, formë tjetër dhe me kombinime tjera nuk e shkelin markën tregtare të paditësit.

Gjykata ka gjetur se ekzistojnë dallime të dukshme edhe në elementin “aural” sepse shenja “[“J...”]” dhe “Sende” kanë dallime të theksuara në shprehjen e tyre, madje ato janë plotësisht të ndryshme, andaj edhe në këtë element produkti i të paditurës nuk mund të shkaktojë konfuzion te konsumatori.

Po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe formën e paketimit të produkteve përkatësisht formën katrore-drejtëndëshit të ambalazhit e cila është e njëjtë tek produktet e palëve në procedurë dhe se në këtë rast forma përbën “një formë funksionale” të vetë produktit siç parashihet edhe në nenin 6 pika 1.5 të Ligjit për Markat Tregtare i cili e ndalon mbrojtjen e shenjave të cilat përbejnë një trajtë që “1) rezulton nga natyra e vetë mallit përkatës, 2) është e nevojshme për të arritur një rezultat teknik ose 3) i jep vlerë thelbësore mallit në fjalë”, andaj sipas kësaj dispozite një formë që është funksionale nuk mund të gëzojë mbrojtje. Nocioni i funksionalitetit është mekanizëm për parandalimin e monopolit mbi një formë të caktuar të mallit e cila është e nevojshme për arritjen e një rezultati të caktuar. Forma e paketimit të produkteve kontestuese përdoret tek të gjitha produktet e kësaj natyre, prandaj përdorimi i kësaj forme nuk mund të ndalohej, përkatësisht përdorimi i kësaj forme nuk përbën shkelje të markës tregtare.

Po ashtu kjo gjykatë ka gjetur se nuancat, dizajni, pjesëmarrja dhe kombinimi i këtyre ngjyrave në produkte dallojnë dukshëm ndërsa emërtimi i llojeve të frutave përbëjnë fjalë të natyrës së përgjithshme (gjenerike) që ka kuptimin e pemëve, andaj është e zakonshme që shenja të tilla të përdoren në produkte të asaj natyre sepse tregojnë cilësit/përbërjen e produktit dhe si e tillë gëzojnë mbrojtje vetëm në dizajnin grafik specifik.

Po ashtu edhe në paketimet tjera të paditurës ekzistojnë dallime esenciale të produkteve të cilat në mënyrë shumë të qartë dallojnë në mes veti, karakteristika këto që i bëjnë të dallueshme produktet në mes veti, andaj të gjitha këto e bëjnë që të mos të përmbushen kushtet e parapara në nenin 6 dhe 7 të Ligjit mbi Markën Tregtare, sepse nuk ekziston mundësi e mashtrimit të konsumatorit sa i përket shenjave dalluese të këtyre paketimeve, andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Neni 8 i LMT-së, kërkon ekzistimin e identitetit në mes markave/shenjave në diskutim dhe mallrave apo shërbimeve në fjalë. Ky nen, nuk imponon provimin e mundësisë së shkaktimit të konfuzionit tek konsumatori relevant, midis markës së mëhershme dhe markës për të cilën pretendohet se shkel markën e mëparshme. Se kur dy marka mund të konsiderohen identike dallohet varësisht nëse kemi të bëjmë me markat fjalë apo markat figurative ose të përziera. Për tu konsideruar identike këto dy marka duhet të jenë plotësisht të njëjta, respektivisht dizajni,

kombinimi i ngjyrave dhe figurave, përshkrimet në amablazh, fonti i shkronjave duhet të jenë identike. Në rastin konkret të gjitha elementet e cekura dallojnë dukshëm.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të autorizuarit të palës paditëse lidhur me kërkesëpadinë e tij, mirëpo këto pretendime gjykata i refuzoj si të pa bazuara për arsye se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar sipas arsyetimit të lartë cekur ashtu që marka tregtare e paditësit nuk është shkelur nga e paditura andaj edhe kërkesat tjera të paditësit nuk qëndrojnë pasi që markat tregtare dallojnë në mënyrë esenciale mes veti, prandaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me aktvendim ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të palës së paditur lidhur me caktimin e ekspertizës financiare për arsye se kërkesëpadisë së paditësit i mungon baza juridike e kërkesëpadisë, andaj edhe gjykata e refuzoj një propozim të tillë për hire të mos zvarritjes së procedurës dhe ekonomizimit të saj.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 dhe paragrafin 5 lidhur me nenin 463 paragrafi 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësit i referohen shumës së precizuar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga i padituri dhe atë: për përgjigjen në padi shumën prej 208.00 euro, si dhe në emër të përfaqësimit në dy seanca gjyqësore (2x270.40 euro) shumën prej 540.80 euro, gjithsej shumën prej 748.80 euro.

Andaj nga të cekurat si më lart dhe duke u bazuar në nenin 5, 6, 7 të Ligjit për Markat Tregtare si dhe në nenin 143 të LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti Për Çështje Ekonomike
III.EK.nr.725/19 me datë 09.11.2020

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e marrjes së tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.